

NUTRIKA

Botimet OSHTIMA

nr. 1, janar 2017

Çfarë është NUTRIKA

Nutrika është një fletore e vogël për çështje të mëdha. Nutrika ka vendosur të heqë dorezat dhe të kapi me grushta, kolerën dhe viruset që po sëmurin dhe këta pak njerëz që na kanë ngelur. Nutrika nuk do gurravitet për të drejta njeriu dhe liri të fjalës. Kush pret të marri të drejta nga njerëzit, ato drejta që burojnë nga natyra, është një kalbësirë dhe për këta ka një ambasadë apo një komisioner. Nutrika do merret me çështje të gjakut, familjes, traditës. Kush lufton këto të trija është një armik i Nutrika dhe për armiqt ka vetëm një trajtim, grushta.

Ideologji dhe nacionalizëm

Në numrin 9 të revistës që del në Korçë "Bota e re" është botuar një artikull me mbifjalën "Nacionalizëm". E kënduam dy herë. Është shkruar nga një njeri, që di të shkruajë dhe që s'di se ç'shkruan. Dhe me qënë se s'ka asnjë nënshkrim ose pseudonim, merret vesh se përfaqëson mendimin e revistës. Dhe është për këtë shkak që shtrëngohemi t'i japim një përgjigje sot.

Shkruhet në atë artikull:

"Ka ca kohë që në vendin tonë nacionalizmin nuk e quajnë atribut të vetëkuptuarshmë të çdo Shqiptari të mirë... atë e lidhin me disa doktrina ideologjike... nuk mjaftoka të jesh Shqiptar i flaktë, të duash përparimin e vendit, të vesh interesat e përgjithshme përmbi interesat vetjake... që të quhesh nacionalist. Tani u dashka të jesh anëtar i një ideologjie që kanë çpikurtanivonë."

vijon në faqen 9

Në brendi

- Mentalitet inferior fq. 2
- Bujani si plan i Partisë Komuniste Jugosllave fq. 4
- Ideologji dhe nacionalizëm
- Nga Anadolli lindor në Berlin fq. 10
- Universalizimi dhe nacionalizmi fq. 15
- Intervistë me Gianluca Iannone Udhëheqësi i CasaPound (Itali), fq. 16
- E vërteta!, fq. 20
- Sport dhe Libra, fq. 23
- Antitviruse (MVSK) (RRSH)

Mentalitet inferior

Konceptet kryesore të shprehura dhe të përshtatura në politikat e shqiptarëve në FYROM, por edhe më gjerë kryesisht në çerek shekullin e fundit, janë koncepte që kanë krijuar fytyrën idiote të një populli viktimë, të paaftë, të sakrifikuar dhe të varfër.

Në këtë mendsi mbase gjendet dhe shkaku kryesor i gjendjes së sotme të shqiptarëve, ku përveç faktorëve të tretë mbi imponimet politike, mentaliteti komunist i ndërtuar nga Jugosllavia edhe brenda territorit të Shqipërisë politike është faktori bazë i rrënjosjes dhe i zhvillimit të këtij projekti vetshkatrrues.

Këto koncepte kanë sjellë ravijëzimin e një politike shqiptare të orientuar gjithmonë majtas, deficiente dhe të pafuqishme, për tu përballur me të tjerët. Akoma më i dhimbshëm është fakti i ekzistencës së një vetëdije të sipërfaqshme kombtare, dhe se ky komb është i pavlefshëm dhe i pafuqishëm në përballje me të tjerët. Në këtë mënyrë zhvillimi i kësaj politike në FYROM ka sjellë izolimin e vazhdueshëm të shqiptarëve brenda një popullsie fshatare të arsimuar pak që gjithmonë e më shumë vjen duke u zvogëluar. Megjithatë, linja komuniste e mendimit politik dhe intelektual e ka artikulluar dhe propaganduar këtë "si një popull fatal në difenzivë të përjetshme" dhe fatkeqësisht ky koncept është bërë udhëheqës i frymës politike atje. Kjo e argumentuar dhe me pasqyrimin e rrejshëm të historisë shqiptare, me manipulimin dhe tjetërsimin e saj, në përputhje dhe në interes të këtij koncepti, duke vepruar dëmshëm mbi psikologjinë kolektive të shqiptarëve nëpërmjet mjeteve të edukimit, arsimimit dhe formimit, duke i ambjentuar ata me një gjendje inferioriteti të paqenë. Nëse realisht shqiptarët do të ishin të përshtatshëm për këtë koncept

(fatalistë dhe difenzivë), kjo do të përbënte në të vërtetë një realitet të dhimbshëm, sepse një popull, një komb që paraqet veç vlera pasiviteti dhe tkurrjeje, është i destinuar të jetë përherë objekt i synimi i idesë komuniste sepse paraqet vlerat e larta multikulturore të zhdukjes së kombeve. Fatmirësisht historia ka provuar se shqiptarët, ashtu si dhe kombe të tjerë europianë, janë vitalë dhe në varësi të kohërave kanë qënë në difenzivë të detyrueshme apo edhe në ofenzivë të favorshme. Vetë ekzistenca e tyre mijëvjeçare dhe mos-shuarja e tyre, vërteton tezën e kundërt të asaj që propagandohet.

Me argumentin tjetër fatalist "komb i coptuar dhe shtet i vogël" punohet në çdo politikë, mendim intelektual të majtë, në çdo trajtim të shqiptarëve në krahasim me të tjerët, qofshin këta edhe fqinjët që njëkohësisht bëjnë armikun e përhershëm.

Ngulitja e kësaj mendësie se përherë kemi qenë të vegjël dhe jemi të vegjël edhe sot, ka bërë që të hartohen politika të mjerueshme dhe aspak të justifikueshme për potencialet shqiptare, është përpjekur të ngjallet keqardhja dhe mëshira për shqiptarët dhe jo konsiderata dhe respekti i detyrueshëm dhe imponues i potenciali të tyre, gjë që në zgjedhjet e fundit vrau identitetin e 70 mijë shqiptarëve që votuan CDCM në FYROM. Zhvillimi i vazhdueshëm i komunizmit atje ka sjellë si rrjedhojë zvjerdhjen prej vetvetes të shqiptarëve dhe një ndjenjë të paryeshme inferioriteti karshi të tjerëve. Është për tu përmendur se realiteti shqiptar në kohë të ndryshme na jep tjetër panoramë raportesh, të paktën me popuj të tjerë rrethëqark. Duke mos folur për ato periudha kur edhe me popullsi edhe me territore të përfshira në organizime shtetërore (të natyrshme për kohën) shqiptarët mbisundonin në gadishull, vetëm duke u ndalur në kohën

e tashme verëjmë se për nga raporti i popullsisë aktive shqiptarët mirë që mbesin mbrapa të tjerëve, por dhe janë kaluar nga shumica. E gjithë kjo duke u bazuar vetëm në trevat me popullsi kompakte shqiptare, sepse nëse do të përfshinim edhe komunitete të tjera të konsiderueshme, si ato të arvanitëve në Greqi i apo ato të shqiptarëve të Stambollit, raporti popullativ do të ndryshonte. Rrjedhimisht, intelektualiteti i majtë i supozuar si i paanshëm politikisht ka arritur me sukses të krijoj një përllogaritje të atillë që ul numrin popullativ për sa i përket kombit, dhe ngrë numrin popullativ për sa i përket grupit pa identitet brenda një kombi tjetër. Përsa i përket kësaj pikpamjeje politike më e drejta do të ishte që askush të mos viktimizohej, mos qurravitej lart e poshtë tek ndërkombtarët se jemi duke u keqtrajtuar. Se nëse shteti i sotëm shqiptar i ka themelet zyrtare në fund të vitit 1912, kjo nuk do të thotë se procesi ka mbaruar dhe se shqiptarët që mbetën jashtë duhet të kërkojnë të drejtat e tyre në shtete respektive ku ndodhen, por në vazhdimësi këto kufij duhet të zgjerohen për të falur jetë më të mire brezave. Kaq gjë të gjithë i detyrohen gjakut. Pra, aftësia shtetformuese e shqiptarëve nuk mund të vihet në diskutim. Për këtë nuk duhet të zgjatemi fort, sepse dëshmitë historike rrëfejnë të kundërtën, dhe përfundimet logjike që rrjedhin duke iu referuar rëndësisë së tregjeve dhe rrugëve të vjetra që përshkonin Gadishullin duke u nisur nga portet shqiptare e përshkoheshin në qendrat e fuqishme tregëtare po shqiptare - janë në kundërshti me këtë koncept. Keqadministrimi i pasurive në këtë shekull nuk tregon për varfëri të përhershme, por veçse për politika të manipuluar prej të tjerëve që kanë interesa jetike që shqiptarët të mos shfrytëzojnë potencialet e tyre ekonomike dhe pasurore në të mirë të tyre.

Këto dhe koncepte të tjera të këtij lloji gjithmon me orientim politik majtas, si ai që trajtuam më gjatë në këtë shkrim, pra "racizmi" i supozuar i të tjerëve mbi shqiptarët, kanë sjellë detyrimisht dhe një gjendje të mjerueshme të politikës së zhvilluar në Shqipëri sidomos në dekadat e fundit.

E keqja është se këto koncepte po artikuloohen dhe po pasurohen dita-ditës me derivatet e tyre që paraqiten në ballafaqim me të tjerët në një profil ankimtar me gjenezë anarkiste, dhe në raportet me të tjerët shqiptarët marrin atributet e viktimizimit të paqenë. Përkundër vlerave racore, kombëtare, potencialeve njerëzore e lëndore, potencialeve mendore e shpirtërore, - politika dhe shtresa intelektuale apo grupime mendjehapura të shoqërisë shqiptare prezantohen në arenën ndërkombëtare të pafuqishme, të paaftha, të papërfillshme. Mosrespektimi për vetveten i ngulitur nga një ide e huaj është shkak kryesor i pozicionimit të pafavorshëm të realitetit shqiptar.

Si përfundim të këtij shtjellimi se a janë shqiptarët viktimë, mund të themi se kurrfarë viktimizimi real nuk mund të zhvillohet te shqiptarët, dhe nuk është kurrfarë racizmi nuk është zhvilluar ndaj nesh. Aq më tepër prej racash e popujsh më të poshtëm e më të nënvlershëm se ne. Kundër shqiptarëve ka punuar vetëm një ide titanike e mobilizuar mirë, e ardhur nga jashtë dhe e sponsorizuar po aq mirë.

Ndërsa institucionalizimi dhe mekanizmat e luftës kundër "racizmit" në gadishull, aq të parapëlqyer nga politikat ndërkombëtare dhe të mirëpritura nga mercenarizmi politik shqiptar, janë të pamotivueshëm përse kohë tek shqiptarët nuk është formuluar kjo ndjenjë, dhe nuk janë krijuar kushtet organizative për ta zhvilluar në sistem, për ta aplikuar motivisht mbi të tjerët që s'kanë atë shkallë superioriteti racor. ⇨

Sot, "Racizmi" në Gadishull s'është veçse një shprehje e paaftësisë dhe inferioritetit të individëve të veshur me pushtet politik dhe publik, mjerisht vetquhen shqiptarë, dhe të atyre që kanë informacion të pamjaftueshëm dhe të keqtrajtuar për realitetet kombtare.

Fronti lindor

Një mikut

Kur un' të zhdukem në Hiçin
nga i cili erdha
ti mos u trand... vazhdo ec më
tutje
dhe nga kënga ime e coptuar
të bësh një melodi
që brezi tjetër që po vjen
të njohë të vërtetën madhëri.

Ismet Toto - 1936

Bujani si plan i Partisë Komuniste Jugosllave

Në mbledhjen e dytë të AVNOJ-t çështja e Kosovës nuk u përmend fare. Aty nuk mori pjesë asnjë delegat nga Kosova apo nga viset e tjera shqiptare, ku u vendosën shumë çështje në lidhje me statusin e popujve të Jugosllavisë për vetvendosje deri në shkëputje. Shqiptarë këtu nuk u përmendën fare, por Sanxhakut, Vojvodinës dhe Maqedonisë i jepej e drejta e shtetësisë së plotë si subjekt i barabartë në Federatën e re Jugosllave. Me vendimet që u morën u pa qartë që politika e ndjekur nga PKJ po anonte nga ruajtja e shtetit të vjetër të Jugosllavisë.¹ Pas afërsisht një muaji nga mbajtja e mbledhjes së AVNOJ-t në 29 nëntor në Jajcë të Bosnjes, u morën masat për hapjen e Konferencës së Bujanit. Ideja e formimit të Këshillave Krahinorë Nacionalçlirimtar për Kosovën dhe Rrafshin e Dukagjinit lindi në dhjetor të vitit 1942, pas Mbledhjes së parë të Këshillit Antifashist Nacionalçlirimtar të Jugosllavisë në Bihaq. Ajo u përkrah nga B.Vukmirovic, sekretar i Komitetit Krahinor të Partisë Komuniste Jugosllave për Kosovën dhe Rrafshin e Dukagjinit dhe Ramiz Sadiku, anëtar i Byrosë politike të Komitetit Krahinor, por vrasja e këtyre dy udhëheqësve bëri që kjo çështje të shtyhej.²

Vendimi për mbajtjen e Konferencës u mor gjatë konsultës VI të KK të PKJ për Kosovën dhe Rrafshin e Dukagjinit, të mbajtur në malet e Sharrit, më 3-5 nëntor 1943.³

Konferenca që po përgatitej të mbahej është theksuar shpesh nga studiues të shumtë që lindi si një opozitë që synonte t'i kundërvihej objektivave të Lidhjes së Dytë të Prizrenit. Kjo dhe për shkakun se tashmë organet e Lidhjes e kishin shtrirë pushtetin e tyre në një pjesë të madhe të katundeve, nënprefekturave dhe prefekturave të vendit.⁴

Konferenca i zhvilloi punimet në kullën e Sali Manit, bajraktarit të Krasniqes nga 31 dhjetori i 1943 deri në 2 janar 1944.⁵ Kjo ngjarje ka hyrë në histori me emrin Konferenca Themeluese e Këshillit Nacionalçlirimtar për Kosovën dhe Rrafshin e Dukagjinit.⁶ Arsyeja e mbajtjes së mbledhjes në Bujan ishte e thjeshtë, vetëm aty e kishin të sigurtë jetën e tyre komunistët pasi në asnjë pjesë tjetër të territorit ku kishin kontroll forcat e Lidhjes dhe popullsia e qyteteve të Kosovës nuk i mbështeste në asnjë mënyrë për arsye se shikoheshin si një element përçarës midis shqiptarëve dhe persona të shitur tek serbët.

Në Konferencë u ftuan 61 delegatë por vetëm 49 prej tyre morën pjesë.⁷ Përveç Plavës dhe Gucisë që u trajtuan si pjesë e pandarë e Kosovës nuk u ftuan përfaqësues nga trevat e tjera shqiptare jashtë Kosovës, çka dëshmon për një vizion jo të plotë për zgjidhjen e çështjes shqiptare.⁸ Thirrja e delegatëve e tregon dhe konceptin e organizimit të kësaj konference. Mbledhja e tyre vetëm nga terriore të kufizuara dhe pa përfshirë delegatë që përfaqësonin zona apo krahina nga Shqipëria e 1913 të çon dyshime që është një manovër e PKJ, kjo dhe për faktin e thjeshtë sepse aty po tregohej që komunistët e Kosovës kërkonin të organizoheshin jashtë PKSH duke treguar indirekt që Kosova nuk do të ishte asnjëherë pjesë e shtetit amë. Anëtarët e Konferencës në të vërtetë ishin zgjedhur në mënyrë selektive më parë, kjo vërehet dhe në porosinë që jep P.Joviceviqi për sekretarin e Komitetit Qarkor të PKJ të Rrafshit të Dukagjinit, I.Shaqirit ku theksohej se: njerëzit që nuk janë tanët të mos i dërgoni në Konferencë."⁹ Kjo nënkuptonte që ata që do të dërgoheshin të ishin njerëz të bindur të strukturave komuniste jugosllave, dhe që nuk do të përbënin problem për çështjen shqiptare, pasi në të kundërt kjo konferencë do humbiste "rëndësinë" apo arsyen e vërtetë

përse u mbledh. Organizimi dhe drejtimi i Konferencës u bë nga komunistët kjo dhe për arsyen se ata shkuan si një organizim politik dhe personat e tjerë shkuan si individë dhe pa asnjë organizim. Në Konferencë përveç referateve u zhvilluan dhe diskutime nga të cilat interes më të madh zgjuan ato të P. Joviceviqit në diskutimin që i thuri laved LNC të Jugosllavisë nën udhëheqjen e PKJ.¹⁰ Më 2 janar 1944 pas diskutimesh, u propozua që një komision i posaçëm të përgatiste rezolutën me konsensusin e delegatëve e cila u lexua në dy gjuhë, shqip dhe serbokroatisht dhe u miratua njëzëri dhe u firmos nga të gjithë delegatët.¹¹

1. "Kosova e Rrafshi i Dukagjinit asht një krahinë e banueme me shumicë nga populli shqiptar, cili si gjithmonë edhe sot dëshiron me u bashkue me Shqipnin".¹²

2. Rruga e vetme që populli shqiptar i Kosovës dhe Rrafshit të Dukagjinit të bashkohet me Shqipnin asht lufta e përbashkët me popujt e tjerë të Jugosllavisë..., sepse kjo asht e vetmja rrugë për me fitue lirinë dhe me vetvendosë deri në shkëputje.¹³

3. "Garancija për këtë asht ushtria Nacional-Çlirimtare e Jugosllavisë dhe ushtria Nacional-Çlirimtare e Shqipnis, me të cilën ngushtësisht asht e lidhun. Përveç këtyre, për këtë garantojnë aleatët tonë të mëdhenj Bashkimi Sovjetik, Anglija e Amerika.¹⁴ Rezoluta e miratuar ishte në përputhje me Kartën e Atlantikut, e cila garantonte të drejtën për vetvendosje kombëtare.¹⁵ Dhe sa realisht këto pika që komunistët i propaganduan gjatë luftës u realizuan pas saj??

Sa e fortë ishte garancia e Aleatëve të Mëdhenj??

Këto pas luftës mbetën thjesht premtime që nuk do të realizoheshin kurrë. Garancia e Aleatëve në këtë pikë u shua. Ata që propagandonin vetvendosjen e kombeve dhe përhapjen e demokracisë,



Kosovën e harruan.

Në këtë lojë të stisur nga udhëheqja e PKJ u mbështet "fuqishëm" bashkimi i Kosovës me Shqipërinë për të vetmen arsye se pa mbështetjen e një Kosovë shqiptare, të pranishmit në Konferencë e kuptonin që nuk do të kishte mbështetje tek popullsia.¹⁶ Qëndrimi i pjesës më të madhe të popullsisë ishte kundër komunistëve, pasi ideologjia komuniste identifikohet me nacionalizmin serb, i cili kishte lënë gjurmë të thella në ndërgjegjen e shqiptarëve të trojeve, të cilët i shihnin serbët si armiq të papajtueshëm.¹⁷

Pas miratimit të rezolutës dhe pas telegrameve të dërguara, Konferenca faktikisht u shndërrua në Këshillin Krahinor Nacionalizimtar për Kosovën e rrafshin e Dukagjinit. Për të drejtuar këtë këshill u zgjodh një Kryesi e Këshillit e përbërë prej 9 anëtarësh, të cilët ishin: Mehmet Hoxha (kryetar), Rifat Berisha dhe Pavle Joviceviq (nënkryetarë), Hajdar Dushi (sekretar), Xhevdet Doda, Fadil Hoxha, Millan Zecan, Zekria Rexha, Ali Shukriu (Anëtarë).¹⁸ Në këto kushte kur ekzistonte një KK i PKJ për Kosovën dhe rrafshin e Dukagjinit, si dhe Shtabi kryesor UNÇ për Kosovën, me të njëjtattribute e kompetenca që kishin edhe organet më të larta të ushtrisë e të partisë në pjesë të tjera të Jugosllavisë.¹⁹

Formimi i KKNÇ përcaktoi pozitën e veçantë të Kosovës gjatë Luftës së Dytë Botërore, barazinë e saj me Republikat e tjera që kishin qenë nën Jugosllavinë dhe të drejtën për shpëtim dhe për bashkim me Shqipërinë.²⁰ Në kohën kur u miratua kjo rezolute u cilësua një hap i madh për Kosovën, i arritur nga komunistët kosovarë pasi ata nuk e njihnin faktin real që ishte evident kudo.

Në rrethanat kur flasim kemi një shtet shqiptar i cili, e ka të shtrirë administrimin e tij në territore më të gjera se Shqipëria e 1913 pra dhe në Kosovë e pjesën perëndimore të Maqedonisë ose thënë ndryshe territoret e banuara etnikisht me shqiptarë.

Administrata në këto vende është tërësisht shqiptare dhe varet nga pushteti qëndror në Tiranë. Pra komunistët kishin vënë si qëllim të realizonin diçka që tashmë ishte realitet, gjë që është një absurditet.

Nacionalistët ishin të parimit se bashkimi me Shqipërinë nuk mund të vinte asnjëherë nëpërmjet një bashkëpunimi me armiqtë e vjetër të kombit që jo më larg se një dekadë më parë kishin kryer reprezalje mbi popullsinë dhe kishin ndjekur politika shkombëtarizuese deri edhe në largimin me forcë të shqiptarëve nga shtëpitë e tyre dhe duke sjellë në to serbë e malazëzë. Pikëpamje e nacionalistëve do të rezultojë mëse e vërtetë. Në fillim, pas përfundimit të Konferencës, Enver Hoxha e pranoi Rezolutën si një e drejtë e shqiptarëve e ardhur në mënyrë legjitime nga përfaqësuesit kosovarë.²¹ Por në këtë mendim nuk ishin anëtarët e lartë të PKJ.

Që në janar të 1944 Pavle Joviceviq, pjesmarrës në konferencë dhe nënshkrues i Rezolutës, sipas një qortimi që kishte marrë nga S.Tempoja, i shkruante atij: "Para se t'a merrnim letrën tënde, e pamë gabimin që kemi bërë - atë kur kemi rrëshkitur në vijën e Ballit Kombëtar dhe të qëndrimit të masave."²² Kjo u vërejt dhe nga anëtarët e tjerë të Konferencës kur morën vesh për vendimet e Jajcës. M. Gjillasi në një letër dërguar KK të PKJ për Kosovën, ai i tërhiqte vëmendje lidhur me vendimet e Konferencës. Sipas tij në "Mbledhjen e Sharrit" nuk ishte dashur të krijohet KK i PKJ për shkak se krahina juaj nuk është një qark kompakt...Këshilli juaj nuk mund të kishte karakter pushteti por vetëm uniteti të masave.²³ Në këtë mënyrë PKJ nuk i njihte atributet e pushtetit politik të KKNÇ të Kosovës, ndërkohë këtotribute ua njihte popujve të tjerë: kroatëve, malazëzëve, serbeve etj.

Gjithashtu vazhdohej se duhet të mos e ndryshonte emrin nga Metohi në Rrafsh i Dukagjinit me arsyetimin se Rrafshi i Dukagjinit shtrihej dhe në pjesën e kufirit të Shqipërisë politike. Vendime e Konferencës u sulmuan për dy problemet kryesore: shpalljen e popullit për vetvendosje dhe për barazinë në raport me krahinat e tjera të Jugosllavisë që më vonë u quajtën republika.

Nga këto sulme të sllavëve, sa nga ata të ashtuquajtur patriotë, anëtarë të Konferencës që kërkonin bashkimin e Kosovës me Shqipërinë dhe e miratuan këtë rezolutë hoqën dorë nga përkrahja e PKJ???

Asnjë!!! Për më tepër ata u ingranuan edhe më tepër në lëvizje duke filluar edhe ngritjen e tyre në poste më të larta të ushtrisë jugosllave ende pa mbaruar lufta, por edhe duke dhënë urdhër për eliminimin e një sërë nacionalistësh shqiptarë që kishin ngritur krye kundër forcave komuniste, të cilat pas tërheqjes së trupave gjermane kishin marrë kontrollin e qyteteve në Kosovë. Vetë Tito i dënontë vendimet e Konferencës ai thoshte se u jepej përkrahje forcave "kuislinge shqiptaromëdha" të cilët, në bazë të konceptit gjerman luftonin për Shqipërinë Etnike dhe që përgatiteshin të pengonin forcimin e frontit të Luftës Nacionalçlirimtare në Kosovë dhe më gjerë.²⁴ Tito e mbante çështjen e Kosovës pezull dhe vazhdonte t'i qëndronte mendimit se kjo do të zgjidhej pas luftës dhe PKSH nuk bëri thujse asnjë hap që ta kundërshtonte këtë por e ndryshoi qëndrimin e saj dhe mbajti "vijën" PKJ. Qëndrimi i PKJ ishte i tillë dhe ishte në linjën e vjetër që kishte ecur dhe më parë politika serbe. Fatale ishte heshtja nga ana e komunistëve shqiptarë që i qëndruan linjës së politikës jugosllave. Në Mbledhjen e jashtëzakonshme të Kuvendit Antifashist Nacional-Çlirimtar të Serbisë në Beograd në 7-9 prill 1945 Mehmet Hoxha, kryetar i zgjedhur në këshillin e bërë në Kosovë nuk e kundërshtoi

deklaratën e Dushan Mugoshës: "shpreh dëshirën e Këshillit Nacional-Çlirimtar të Kosovës e Metohisë që edhe ne popujt e Kosovës e Metohisë t'i aneksohemi Serbisë federative motër. "Ai mbështeti deklaratën e Mugoshes dhe tha:²⁵ Dëshira e shprehur nga Mugosha nuk e frikëson popullin e Kosovës por e forcon dhe i jep siguri, se do ketë të njejtat të drejta si popujt e tjerë."²⁶ Si ka mundësi që një person i cili në një mbledhje ku ishte vet kryetar ka miratuar një Rezolutë dhe vetëm pak muaj më vonë të ndryshojë qëndrimin e tij dhe të kthehet në anën e armiqve të kombit të tij kur ishin ende të freskëta kujtimet e masakrave që ata kishin bërë kundrejt popullsisë shqiptare të Kosovës???

Mehmet Hoxha e bëri këtë duke shkuar pas linjës së serbëve dhe duke tradhëtuar aspiratat e bashkombasve të tij me qëllimin e thjeshtë, përfitime vetjake. Mbledhja e dytë e KNAÇL të Kosovës nuk u mbajt në verën e 1944. Udhëheqja jugosllave priti që ta kishte totalisht nën kontroll Kosovën edhe pas shtypjes së kryengritjes së Shaban Polluzhës.

Mbledhja e Prizrenit ishte ajo që në njëfarë mënyre vendosi fatin fatal të Kosovës. Pjestarët e Këshillit NÇL për Kosovën të zgjedhur në Bujan do të shpreheshin: F.Hoxha:..."ligjërish në mënyrë demokratike njeherit anulohet pjesa e gabueshme e Rezolutës."²⁷ F. Hoxha do ta përmbledhte fjalën e tij në tre pika: 1) Kombësia serbe në Kosovë është me e madhe pas shqiptarëve, prandaj nuk mund të jenë në një shtet më shqiptarët.

2) Krahina e Kosovës është më e pazhvilluar dhe duke u bashkuar me Serbinë do të zhvillohej.

3) Aneksimi i Kosovës Serbisë do të ndihmonte në forcimin e vëllazëri-bashkimit.

Këto shprehje ta Fadil Hoxhës i cili me gojën e tij anuloi ato që kishte firmosur dhe u shpreh për fatin e Kosovës



sikur të ishte duke vendosur për pronën e tij duke mos marrë parasysh interesat dhe ndjenjat nacionale të popullsisë. Këtë Fadil Hoxha e bëri për një gjë, në të kenë një mendim të sëmurë në përfitim politik pasi menjëherë pas luftës ai mban poste të larta si: anëtar i Kryesisë së Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë, anëtar i Lidhjes Komuniste të Jugosllavisë dhe kryetar i Kuvendit të Kosovës që formohet pas 1945. Pra ishte një nga njerëzit që u shpërblye më mirë nga udhëheqja jugosllave për shërbimet që bëri në dëm të popullsisë shqiptare. Kohët e fundit kanë qarkulluar zëra se Fadil Hoxha duhet të marrë titullin "Nderi i Kombit", megjithëse një ide lokaliste kjo është e hedhur padyshim nga qarqet "e kuqe" që vazhdojnë mendjen e tyre. Titulli më i saktë do të ishte: "Turpi i shqiptarëve". Pra thënë ndryshe Mbledhja e Prizrenit zhvlerësoi vendimet e Bujanit. I hoqi të drejtën popullsisë së Kosovës për bashkimin me Shqipërinë. Pjesëmarrësit në këtë Mbledhje me vullnetin e tyre i hoqën sovranitetin Kosovës, e degraduan në qark autonom nga krahinë autonome që ishte, i shkëputën pjesën lindore (Luginën e Preshevës) dhe i hoqën flamurin duke e bashkuar me Serbinë për shumë dekada deri në çlirimin përfundimtar të saj në vitin 1999. E gjithë kjo farsë mund të cilësohet pa frikë si një manovër politike e PKJ me qëllimin e vetëm për të përçarë shqiptarët. Kujtesa që i bëhet sot Konferencës së Bujanit është vetëm nga njëra anë politike, e majta. Kjo nuk është një ngjarje që kombi shqiptar duhet të krenohet, por një ngjarje që e bën të turpërohet.

1. Vebi Xhemaili, Forcat Kombëtare në mbrojtje të Shqipërisë Etnike, (Tetovë: Tringa Design, 2006), 193.

2. Muhamet Shatri, Kosova në Luftën e Dytë Botërore 1941-1945, (Tiranë: Toena, 1997), 112.

3. Po aty.

4. Shefqet Hoxha, Konferenca e Bujanit, parë

ndryshe në: E Djalta Shqiptare në Mbrojtje të Shqipërisë Etnike, (Prizren: Lumbardhi, 2006), 171.

5. Noel Malcolm, Kosova: Një histori e shkurtër, (Prishtinë: Koha Ditore, 2001), 320.

6. Shyqyri Hysi, Histori Trojeve dhe Diasporës Shqiptare, (Tiranë: SHBLU, 2007), 112.

7. Muhamet Shatri, Kosova... , 116.

8. Po aty.

9. Po aty.

10. Po aty.

11. Kastriot Dervishi, Historia e Shtetit Shqiptar 1912-2005, (Tiranë: Shtëpia Botuese 55,2006), 510.

12. Shefqet Hoxha, Konferenca e Bujanit..., 169.

13. Po aty..

14. Po aty.

15. Bernd Fischer, Shqipëria. gjatë Luftës 1939-1945, (Tiranë: Çabej, 1999), 310.

16. Po aty.

17. Shyqyri Hysi, Histori e Trojeve, 115

18. Po aty.

19. Muhamet Shatri, Kosova..., 124.

20. Po aty.

21. Vebi Xhemaili, Forcat... , 194.

22. Muhamet Shatri, Kosova..., 124.

23. Po aty.

24. Vebi Xhemaili, Forcat... , 195.

25. Shefqet Hoxha, Konferenca e Bujant..., 176.

26. Po aty.

27. Po aty.

SHKUMBINI

«Të rritë pesimistë, që thonë se gjithçka është mizeria dhe që mizeria do të jetë, janë të dëmshëm, sa edhe ata që thonë, se jetojmë në më të mirën e botëve».

Bota e re - 1936

Ismet Toto

Ideologji dhe nacionalizëm

vijon nga faqja 1

Dhe pakëz më tutje shkruhet: "nacionalizma Shqiptare duhet t'ushqehet me traditat e shenjta t'epokës Heroike..." dhe më tutje thotë që dëshmorët dhe atdhetarët që punuan "duhet të jenë yll drejtonjës i të gjithë rinisë Shqiptare..." Gjer këtu cituam për t'i dhënë një ide këndonjësit inteligjent mbi përmbajtjen e pjesës që na intereson të atij artikulli. Tashti do të shfaqim edhe pikëmapjet dhe bindjet tona po me atë kthjelltësi dhe pa nënkuptime.

Nuk dimë të jetë thënë ndonjëherë që nuk mjafton të jesh shqiptar i flaktë për të qenë nationalist. Kjo është një absurditet. Është thënë se kohët e sotme kërkojnë një "patriotizëm aktiv" dhe nacionalistë që s'janë të zotë të bëjnë e të thonë asgjë të mirë dhe në këtë rast kemi pasur në mend jo popullin mbarë, po ata njerëz, që merren me punët e shoqërisë në ndonjë mënyrë.

Nuk është thënë nga ne as gjysmë fjale kundër traditës sonë heroike. Përkundrazi, na jemi mbështetur mbi atë. Po kemi shtuar se ideali i vjetër i bërjes së Shqipërisë, për të cilën ranë dëshmorët tanë, u realizua... Shqipëria u bë. Tashti do të kemi një ideal të ri: Ta bëjmë Shqipërinë të lumtur, të madhe dhe sidomos të fortë. Dhe për të bërë këtë punë, na duhet të shikojmë edhe rrethepërqark se ç'bëjnë popujt e tjerë dhe të inspirohemi në mënyrën tonë në atë drejtim. Dhe kemi shtuar se heronjtë tanë do të jenë për ne burim inspiracioni për sakrificë, por sidomos figura gjiganteske e udhëheqësit të kësaj epoke të Rilindjes Kombëtare, do të jetë dominonjësja dhe drejtonjësja e jetës së re shqiptare, që akoma s'ka filluar të jetojë një klimë të fortë përpjekjeje, reformash dhe rindërtimi moral e lëndor.

Nuk është thënë asnjë herë në shtyllat tona se kush nuk është pro ideologjisë së

ré, nuk është shqiptar.

Po me bindje të sigurtë është pohuar çiltaz se çdo shqiptar nationalist i mirë është pro ideologjisë së ré, sepse kjo është sinteza e frymës së nacionalizmit shqiptarë të ndërgjegjshme. Nëqoftëse ka nacionalistë shqiptarë, që janë kundër ideologjisë së re, këta ose s'kuptojnë qartë ç'është ideologjia, ose ngatërrojnë çështje personash me çështje parimesh, ose tërhiqen nga hunda nga njerëz, që kanë shumë maska për fytyrën e tyre. Sepse nuk mund të kuptohet që një nationalist shqiptar të jetë kundra ideologjisë së re, kurse ajo ideologji nuk është veçse përmbledhja e dëshirave dhe mendimeve të tij në punë patriotizmi. Dhe s'ka shqiptar nationalist, që të mos të dojë Atdhenë e tij të organizuar, të vleftësuar, të disiplinuar, të pasur, të dinjitetshëm dhe të fortë. Fare llogjikisht, pra, s'ka shqiptar nationalist, që të mos jetë pro ideologjisë së re, e cila, siç është provuar në kaq raste dhe me kaq shembëlla, është e vetmja udhë, që shpie tek ato përfundime që përmëndet.

Atëherë ç'janë këto drejtime? Ç'janë këto kritika të endura sofistike? Pse mënjanë flitet me retorikë për Atdhe e Komb dhe më anë tjetër kërkohet që këto të jenë sa më të vdekura dhe sa më të pazonjat të shtyjnë vendin në udhën e mbarë të shëndetit shpirtëror? A nuk është koha që të rrimë e të mendojmë pakëz seriozisht dhe sinqerisht dhe të përpiqemi të shohim qartë? A nuk është koha akoma që edhe kritika jonë të bëhet jo me qëllim që të provojmë se kemi bërë keq, s'duhej bërë ashtu, ne s'jemi të zotë për atë e këtë, etj., por të flasim, sesi duhen bërë punët, që të bëhen mirë dhe të përhapim një frymë se do të jemi të zotë që të bëjmë një Atdhe nga çdo pikëpamje të ndritur?

Ismet Toto

Arbënia, 1936

Nga Anadolli lindor në Berlin Walter Laqueur

Numri i emigrantëve myslimanë në Gjermani është rreth 3.5 milionë, nga të cilët rreth 75% me origjinë turke. 1/3 e tyre jetojnë në rajonin e Renit të Ulët-Vestfalisë dhe 1/3 tjetër në Berlin. Është një komunitet shumë më i ri në moshë se shoqëria gjermane dhe njëkohësisht ka një lindshmëri shumë të lartë. Punëtorët e parë turq mbërritën në vitet pesëdhjetë dhe u punësuan nga sipërmarrjet gjermane që kishin nevojë për krahe pune; në atë kohë mendohej se do të jetonin në Gjermani vetëm përkohësisht, por në një fazë të parë vetëm pak prej tyre u kthyen në Turqi, më vonë kur ju ofrua një shumë të hollash për t'u kthyer në vendlindje, rreth 50 000 u larguan. Në vitet shtatëdhjetë nevoja për punëtorë të huaj ra shumë, por punëtorët e rinj që ishin vendosur në Gjermani shkuan në fshatrat e origjinës dhe u kthyen me nuset e tyre. Gjithsesi, emigrimi nga Turqia vazhdoi pasi edhe politikat e qeverisë e lehtësonin; të porsaardhurit kërkonin azil politik pasi përndiqeshin në vendin e tyre (si kurdët për shembull), kërkesat pranoheshin edhe pse azili në të vërtetë ishte një kërkesë dytësore pasi niveli i jetesës në Gjermani ishte shumë më i lartë dhe nëse emigrantët nuk gjenin punë, Shteti i ndihmonte.

Në asnjë vend tjetër refugjatët nuk u ndihmuan aq shumë nga institucionet që promovonin integrimin e tyre, nga Shërbimet Sociale, nga studiuesit akademik, nga kishat që dëshironin të vendosnin një dialog dhe nga partitë politike, si mjedisorët dhe liberalët, që ishin të interesuar të ngrinin bazat e tyre në këto komunitete. Asistentët socialë dhe "ekspertët e emigracionit" kryen një punë të mirë, si për shembull duke mbrojtur emigrantët nga qiradhënësit lakmitar, por në fund të llogarive sollën më shumë dëme se dobi. U mësuan

turqve hilet si të përfitojnë nga rrjeti i mbrojtjes sociale, që do të thotë të marrësh na Shteti dhe nga njësite vendore maksimumin e mundshëm të asistencës ekonomike, apo të ndonjë natyre tjetër, duke dhënë minimumin e mundshëm për të mirën e përbashkët.

Komuniteti turk kishte nevojë mbi të gjitha për këshilla dhe ndihmë në arsimim, çka do t'i lejonte të përparonte në piramidën sociale. Por, përkundrazi, si mund të vihet re me një shëtitje të shkurtër në qytetet e mëdha si Berlino, Këlni apo Duisburgu, në Gjermani është formuar një shoqëri paralele, dhe problemet janë të njëjta si në Francë dhe Britani të Madhe: getoizim, ri-islamizim, nivel i lartë papunësie mes të rinjve dhe rendiment i ulët në shkollë. Refugjatët turq e kurdë nuk ishin aspak të përgatitur për të jetuar në Evropë. Vinin nga zonat më pak të zhvilluara të Turqisë, Anadolli lindor; shumë prej tyre ishin analfabetë dhe sa i përket besimit fetar dhe bindjeve politike shumë më konservatorë se shtesa e mesme turke në Stamboll apo Ankara. Ndryshe nga shumë refugjatë në Francë apo Britani të Madhe, që përgjithësisht dinin pak frëngjisht apo anglisht, të porsaardhurit nuk dinë gjermanisht. Prandaj nuk të habit fakti që sapo mbërritën, turqit u izoluan në shoqërinë e bashkështetasve të tyre dhe ruajtën zakonet; kishin xhamitë e tyre, dyqanet hallall, dyqanet e perimeve, dhe shumë vende të tjera ku mund të rrinin mes tyre. Nuk mërziteshin nëse fëmijët e tyre ndiqnin shkollat gjermane, por kundërshtonin me këmbëngulje pjesëmarrjen e vajzave në veprimtari sportive, ekskursione me klasën dhe orët e biologjisë ku flitej për seksin. Gjithashtu kundërshtonin dhe çdo lëndë që në ndonjë farë mënyre nuk ishte e pranueshme për fenë e tyre, dhe këmbëngulnin për mësimin e fesë islamike në shkollë, gjë që binte ndesh me kushtetutën gjermane. Në fund

morën atë që donin. Autoritetet gjermane filluan të paguajnë mësuesit e fesë që në shumicën e rasteve vinin nga jashtë, ishin fundamentalistë dhe njihnin pak ose aspak gjuhën gjermane. Nuk ekzistonte asnjë lloj mbikëqyrje mbi edukimin (apo indoktrinimin) që bëhej në këto kurse. Është e vërtetë që autoritetet gjermane vijuan të këmbëngulnin që në këto kurse të përdorej gjermanishtja, por pati kundërshti të forta nga ana e organizatave fetare dhe nga qeveria turke. Gjykatat gjermane, kur ishin në mëdyshje, merrnin vendime pro myslimanëve, duke rrëzuar, për shembull, ankesat e fqinjëve jo myslimanë për zhurmat e altoparlantëve të xhamive që shumëfishonin thirrjet dhe lutjet e hoxhallarëve. Por këto vendime nuk ndikuan në përmirësimin marrëdhënies mes fqinjëve myslimanë dhe jo myslimanë. Myslimanët që u vendosën në Gjermani mendonin se ishin të ndryshëm nga shoqëria që i rrethonte, të cilën nuk e pranonin për arsye fetare apo të ndonjë natyre tjetër. Me ardhjen e familjeve, u rrit dhe vendosmëria e tyre për të mbrojtur dallimet: të ishe si gjermanët cilësohej amorale. Nga ana tjetër askush nuk e shkonte ndërmend të braktiste Gjermaninë në formë proteste ndaj të pafeve; në fund të fundit ajo ishte bota e tyre e vogël dhe me lejen e zotit ndoshta do të mund të bëhej një vend i gjithi i tyre. Është e vërtetë që gjeneratat e reja, sidomos djemtë, kanë përvetësuar mënyrën e veshjessë bashkëmoshatarëve gjermanë, por ndodh ende shumë shpesh që i vetmi libër që kanë në shtëpi të jetë kurani. Duke parë orientimin e saj reaksionar në fushën socio-kulturore dhe fetare, komuniteti turk i Gjermanisë ka tërhequr vëmendjen e forcave fundamentaliste të djathta në Turqi, drejtuar nga Necmitten Erdogan. Partia e tij ekstremiste ka dërguar në Gjermani emisarë dhe imamë dhe në mënyra të ndryshme ka ofruar udhëheqjen e tij. Dy organizatat kryesore ishin grupi Cameleddin Kaplan Khalifat në

Këln dhe Milli Goerues, një shoqatë e themeluar në vitet tetëdhjetë dhe që u përhap me shpejtësi në të gjithë Gjermaninë dhe më pak ndër komunitetet turke të vendeve të tjera evropiane. Grupi Kaplan mbeti relativisht i kufizuar; nuk pranonte parimin e demokracisë dhe shikonte si kundërshtarin e vet kryesor jo aq Gjermaninë sesa Turqinë laike. Sipas fundamentalistëve turq çifutët kishin themeluar dy Shtete, Izraelin dhe Turqinë, pasi themeluesit e Turqisë moderne, xhonturqit dhe Qemal Ataturku, ishin me origjinë doenme*, pra çifutë që shekuj më herët ishin konvertuar në islam me qëllim për ta përmbysur, modernizuar dhe laicizuar hap pas hapi. Kaplani vdiq në vitin 1996 dhe drejtimin e grupit Khalifat e mori i biri, Matin Kaplan. Pak më vonë, heroi dhe mbrojtësi i tyre Erdogan u zgjodh kryeministër i Turqisë, por nuk arriti të rizgjidhej dhe në fund e nxorën nga politika. Ngjarjet në Turqi, që shkaktuan një thyerje mes fundamentalistëve me ndikim edhe ndër turqit në Gjermani, janë përtej kufijve të këtij libri. Mjafton të themi që Erbakani, një profesor fizike që kishte jetuar në Gjermani për shumë vite, u zëvendësua nga Recep Teyyip Erdogan, ish futbollist gjysmë profesionist, i cili pasi kishte qenë një kryetar bashkie mjaft popullor në Stamboll, në 2003 u zgjodh kryeministër. Erdogani, në thelb edhe ai një fundamentalist, u tregua më i kujdesshëm se paraardhësi i tij, duke mbështetur hyrjen e Turqisë në Bashkimin Evropian dhe duke përmirësuar marrëdhëniet me Greqinë, në politikën e brendshme ndoqi një vijë konservatore por më pragmatiste. Këto vitet e fundit, në rrugë zyrtare apo jo zyrtare, qeveria turke i ka kushtuar vëmendje të veçantë komunitetit në Gjermani. Turqit në Gjermani, në shumicën e rasteve, informohen mbi problemet e tyre dhe mbi çështjet



ndërshtetërore nga gazetatat dhe televizionet turke, për shembull «Hurriyet» ka edicione që shtypen në Berlin. Kush shkon në Kreuzberg apo Moabit do të vërë re menjëherë që nuk ka ballkon pa antenë satelitore për të kapur kanalet e mëmëdheut. Lajmet sportive i gjejnë në një botim me emrin interesant «Fanatik». Filmi "ultrapatriotik" Lugina e ujqërve pati një sukses të jashtëzakonshëm mes turqve në Gjermani. Grupi Kaplan, për shkak të radikalizmit të vet, u izolua nga shumica e turqve në Gjermani, madje pati edhe një vrasje politike gjatë luftës për pushtet. Në fund Metin Kaplan u dënua me katër vjet burgim për nxitjen e vrasjes, pasi shleu dënimin u përjashtua nga Gjermani dhe u vendos në Turqi së bashku me familjen (në vendin e tij ishte nën hetim pasi kishte planifikuar që gjatë një përkujtimeje të përplaste një aeroplan mbi mauzoleun e Ataturkut). Ndërkaq, administrata e Këlnit përpqej të merrte mbrapa 200 000 eurot që në formë asistence sociale i ishin dhënë Kaplanit; më herët, gjatë një kontrolli policor në banesën e tij u gjendën një milion dollarë amerikanë dhe një sasi e madhe floriri. Ky rast, ku autoritetet evropian pa dijeni ndihmonin financiarisht veprimtari terroriste ndërsa gjykatat dhe policia për shkak ndërlikimeve politike apo ligjore, kishin vështirësi të merrnin kundërmasa të përshtatshme, nuk është aspak i rrallë. Në fund grupi Khalifat u shpall i jashtëligjshëm, por ndjekësit e tij u organizuan si sekt, ndërkaq që Milli Goerues, që tregohej më i kujdesshëm, u kthye në organizatë masash. Milli Goerues që në krye të herës ka pohuar se respekton kushtetutën gjermane, se beson në demokraci dhe madje pranon "vlerat evropiane". Paçka se përpqej t'i binte në sy për mirë CDU-së, që në atë kohë ishte në pushtet, shërbimet sekrete gjermane (njësia përgjegjëse për mbrojtjen e kushtetutës) dhe shumë ekspertë të tjerë ishin të bindur për të kundërtën. Projekti i Milli Goerues është ai i një vendi të

qeverisur vetëm bazë të ligjit islamik, edhe pse tani duhet të bëjnë disa lëshime deri sa myslimanët të përbëjnë shumicën; drejtuesit pohojnë të mos jenë më shumë antidemokratikë sesa CDU-ja. Deri rreth njëzet vite më parë organizatat fetare turke faktikisht ishin neutrale dhe predikimet nëpër xhamitë e ndryshme ishin apolitike, por që nga ajo kohë grupet më të rëndësishme, përfshirë edhe DITIB që varet nga Ministria turke për çështjet fetare, kanë rënë nën kontrollin e islamikëve, shpeshherë radikalë. Njëkohësisht këto organizata kanë kërcënuar dhe shpesh herë kanë vepruar me kallëzimeve penale kundër atyre që shpalosnin orientimin dhe veprimtarinë e vërtetë të tyre. "Milli Goerues" do të thotë "Vizion Kombëtar" që është edhe titulli i një prej librave të ekstremistit turk Erbakan. Organizata pohon se ka 220 000 anëtarë (shifra e vërtetë dihet të jetë më afër 200 000) dhe në Gjermani drejton rreth 270 xhami. Në vijën e tyre ideologjike, Milli Goerues dhe organizatat e tjera aleate, kanë kritika të ashpra ndaj krishterimit dhe janë haptazi antisemite. Në ndonjë rast kanë mbështetur grupe terroriste, por për sa dihet nuk kanë marrë pjesë drejtpërdrejtë në aksionet e tyre. Al Qaeda dhe organizata të tjera terroriste, që kanë përdorur Gjermaninë si terren rekrutimi përgjithësisht përqendrohen te refugjatët me origjinë arabe apo afrikano-veriore. Objektivi i politikës gjermane të emigrimit ishte integrimi i komunitetit turk, ndërsa objektivi i organizatave islamike të mbështetura nga qeveria turke ishte krejt i kundërt. Turqit në Gjermani mbeten turq edhe pse kanë nënshtetësinë gjermane; qeveria e Ankarasë dëshiron që ata të votojnë për zgjedhjet turke dhe që njëkohësisht, kudo që të ndodhen, të mbrojnë interesat e Turqisë së Madhe, e cila mbetet atdheu i tyre. (Turqit e lindur në Gjermani nuk përfitojnë vetvetiu nënshtetësinë gjermane,

por mund të parashtrojnë kërkesën). Në polemikat me islamikët, institucionet gjermane janë treguar të pafuqishme. Kishat janë përpjekur të hapin një dialog në kërkim të pikave të përbashkëta ndërmjet feve, por nuk gjetën bashkëbisedues, pasi qëllimi i organizatave fetare turke ishte të qëndronin të veçuara pa ndikimin e fesë, kulturës dhe vlerave perëndimore. Këto përpjekje nuk kanë dështuar vetëm në Gjermani: sipas disa raporteve edhe Austria dhe Zvicra kanë të njëjtat probleme të pazgjidhshme. Vetëm në vitet e fundit kishat kanë hequr dorë nga ai që qartazi dukej një mundim i kotë.

Cilat ishin çështjet që kanë shkaktuar kundërshtitë kryesore ndërmjet islamikëve dhe shoqërisë në të cilën (apo paralelisht me të cilën) jetojnë? Sipas autoriteteve gjermane numri u tyre nuk është i jashtëzakonshëm – 3 600 në Berlin – dhe nuk ka pasur rritje të dukshme këto vitet e fundit. Por shifra i referohet vetëm militantëve profesionistë apo gjysmëprofesionist, që nga kjo pikëpamje janë më të fortë se grupet e tjera. Milli Goerues, që autoritetet e kanë renditur si “ekstremiste”, ka me qindra grupe që janë të lidhura me xhamitë e tyre; qëllimi i tyre, për ta thënë hapur, është zëvendësimi i rendit laik të vendit ku jetojnë me një rend bazuar te sheriati, duke nisur fillimisht nga rajonet ku myslimanët përbëjnë shumicën e më tej në zonat që janë prekur nga shtrirja e tyre. Kjo vijë politike është e papërputhshme me demokracinë.

Ata që i njohin mirë këto komunitete thonë se deri tani Milli Goerues dhe grupet e tjera islamike kanë zgjedhur më shumë rrugën e presionit social sesa të veprimit të dhunshëm. Shtatë “vrasjet për çështje nderi” në pesë muaj, të grave që kishin zgjedhur të jetonin lirshëm “si gjermanë” ishin veprime të individëve të veçuar dhe jo pasojë e një fushate të organizuar; fajtorët ja hodhën me pak.

Disa raporte nga Kreuzberg, Wedding dhe nga lagje të tjera japin shembuj interesantë sesi shfaqet ky presion social: ka të rinj që ndalojnë njerëzit në rrugë dhe ju thonë se nëse nuk janë mysliman duhet të ikin nga lagjja; fëmijët gjermanë i përzënë nga këndet e lojërave; në shkolla u bëhet presion jo myslimanëve që të agjërojnë gjatë muajit të ramazanit; vajzave jo myslimane ju thuhet të vishen si vajzat myslimane, ose të paktën të mos veshin minifunde, pantallona apo bluza me mëngë të shkurtra; prindërve ju thuhet që çfarëdo të urdhërojë shkolla, xhamia dhe kurset e saj janë më të rëndësishme. Sipas këtyre raporteve, veprimtarët islamikë nuk kanë ndërhyrë në shpërndarjen e drogës apo në lojërat e futbollit, pasi e dinë që do të hasnin vështirësi nëse i kundërvihen formave popullore të argëtimit.

Një nga çështjet më të debatuar lidhet me gratë. Sipas traditës islamike gratë duhet të ndiqnin shkollën deri në njëfarë niveli; më tej duhej të rinin në shtëpi për t'u përkujdesur për e tyre; qëllimi i tyre, për ta thënë hapur, është zëvendësimi i rendit laik të vendit ku jetojnë me një rend bazuar te sheriati, duke nisur fillimisht nga rajonet ku myslimanët përbëjnë shumicën e më tej në zonat që janë prekur nga shtrirja e tyre. Kjo vijë politike është e papërputhshme me demokracinë. Ata që i njohin mirë këto komunitete thonë se deri tani Milli Goerues dhe grupet e tjera islamike kanë zgjedhur më shumë rrugën e presionit social sesa të veprimit të dhunshëm. Shtatë “vrasjet për çështje nderi” në pesë muaj, të grave që kishin zgjedhur të jetonin lirshëm “si gjermanë” ishin veprime të individëve të veçuar dhe jo pasojë e një fushate të organizuar; fajtorët ja hodhën me pak. Disa raporte nga Kreuzberg, Wedding dhe nga lagje të tjera japin shembuj interesantë sesi shfaqet ky presion social: ka të rinj që ndalojnë njerëzit në rrugë dhe ju thonë

se nëse nuk janë mysliman duhet të ikin nga lagjja; fëmijët gjermanë i përzënë nga këndet e lojërave; në shkolla u bëhet presion jo myslimanëve që të agjërojnë gjatë muajit të ramazanit; vajzave jo myslimane ju thuhet të vishen si vajzat myslimane, ose të paktën të mos veshin minifunde, pantallona apo bluza me mëngë të shkurtër; prindërve ju thuhet që çfarëdo të urdhërojë shkolla, xhamia dhe kurset e saj janë më të rëndësishme. Sipas këtyre raporteve, veprimtarët islamikë nuk kanë ndërhyrë në shpërndarjen e drogës apo në lojërat e futbollit, pasi e dinë që do të hasnin vështirësi nëse i kundërvihen formave popullore të argëtimit.

Një nga çështjet më të debatuar lidhet me gratë. Sipas traditës islamike gratë duhet të ndiqnin shkollën deri në njëfarë niveli; më tej duhej të rinin në shtëpi për t'u përkujdesur për fëmijët dhe të dilnin nga shtëpia vetëm të shoqëruara nga një mashkull i familjes, qoftë ky edhe vëllai i vogël. Shumë vajza, me të gjitha gjasat shumica e tyre, u jepen nuse nga prindërit e tyre të rinjve që as nuk i kanë takuar ndonjëherë – këto janë të ashtuquajturat martesat me detyrim. Ky është kthyer në një problem të rëndësishëm politik falë veprimtarisë dhe librave të disa disidenteve që e bënë të njohur këtë sjellje. Disa "studues të emigrimit" gjermanë janë shprehur se këto kritika janë të tepruara pasi arsyet përgjithësisht janë ekonomike, martesat janë vendosur paraprakisht për të siguruar mirëqenien e familjes. Cilado qoftë arsyeja, studuesit nuk e kanë mohuar ekzistencën e kësaj sjelljeje, por e kanë shpjeguar si një karakteristikë etnike me rrënjë të thella të turqit dhe kurdët; ata gjithashtu mendojnë se autoritetet nuk duhet të ndërhyjnë në këto tradita. Përgjithësisht në Gjermani ka pasur më pak raste dhune ndërmjet komuniteteve myslimane dhe jo atyre jo myslimane sesa në Francë e Britani

të Madhe, por është i madh mosbesimi i ndërsjellët. Me një nivel të lartë papunësie mes të rinjve dhe me ecurinë e keqe në mësim të shumë myslimanëve, fenomene që janë pasojë e motivimit të pamjaftueshëm dhe indoktrinimit islamik, ekziston potenciali për konflikte të mundshme. Në këtë kontekste dy të dhëna marrin rëndësi të veçantë: 40% e të rinjve me origjinë jo gjermane që jetojnë në Berlin nuk marrin diplomën e Hauptschule-s (gjimnazit), që përfaqëson nivelin më të ulët mësimor dhe strehën e atyre që nuk kanë pasur ecuri të mirë në shkollë; një në tre të rinj me origjinë jo gjermane kanë precedentë penalë përpara moshës tetëmbëdhjetë vjeçare. Ai 40 përqindësh që nuk merr diplomën e maturës përbëhet nga meshkuj dhe femra, por duke qenë se, si kemi theksuar, femrat kanë rezultate më të mira mësimore, duket të jetë një problem i djemve të rinj e jo i të gjithë gjeneratës. Nga kjo rrjedh mundësia e dhunës në Berlin dhe në qytete të tjera. Sjellja e disa partive gjermane, që janë përpjekur të mbledhin vota në këto komunitete, nuk ka qenë ndonjë ndihmesë e madhe. Duke u përpjekur të mbrojnë refugjatët nga kritikën, këto parti kanë kundërshtuar integrimin e tyre dhe kanë mbështetur separatizmin, duke përkrahur kështu mbijetesën një shoqërie paralele.

*Dönhem (i konvertuar, apostat, emërtim ofendues) – epiteli me të cilin turqit përkufizonin çifutët ndjekës të Zabbatai Zevit, që kishin përqafuar islamin rreth fundit të shekullit XVII. Komuniteti më i madh doemni ishte i vendosur në Selanik, ku luante një rol të madh social dhe ekonomik. Pas vitit 1924, me shkëmbimin e popullsisë, u vendosën në Turqi, përgjithësisht në Stamboll dhe Izmir, ku gjetën kundërshti të ashpra nga fraksionet "ultranacionaliste" dhe

fundamentalistët islamik. [shënim Nutrika]

Shkëputur nga "The last days of Europe", 2007.
Përkthimi Red. Nutrika.

Universalizmi ose Nacionalizmi

Qysh prej shekujsh vazhdon lufta midis këtyre të dy botëkuptideve. Kjo luftë filloi aty nga i XII shekull me Kartën e Madhe. Filloi në mënyrë të dukëshme kur populli englez vendosi të shkëputet prej influencës së kishës universale. Lufta vazhdon e ashpër edhe sot nën forma të ndryshme. Nga ana e universalistave lufta bëhej dhe bëhet në bazën e një arsyeje shumë herë gjeniale, por gjithmonë arsye të ftohtë dhe spekulonjese. Kurse nacionalistët i ka shtytur instikti, kishe me thanë vetë natyra. Natyra i do individët, do shumëllojshmërinë ndër njerëz, ndër kafshët dhe bimët. Për me i dalë zot ketij qellimi, jo vetem i ka krijuar racat, llojet e kafshëve dhe të bimëve, por ju ka dhanë armët dhe mjetet ma të rafinuara për t'u mbrojtur.

Universalistat nuk pranojnë kufi nga jashtë, por aq me të ngushtë i vënë kufijtë nga mbrenda. Flasin për njerëzin mbarë, për ide të përgjithshme, për njësi dhe vllazëri të përbotshme. Forma e universalizmit është imperializmi, qoftë fetar ose shekullar. Siç, thashë imperializmi përdor si parim të domosdoshëm: Kufi të gjerë nga jashtë dhe të ngushtë nga brenda. Që të kuptohemi ma mirë, po ju jap disa shembuj. Çdo fe e organizuar, që ka tendenca universale, thotë: Më fal arsyen tënde, gjykimin tënd dhe unë të zbuloj të vërtetën absolute. Imperializmi shekullar romak ose englez etj., ka thenë ose thotë: falmë lirinë tande si individ ose si komb dhe unë do të ngreh një shtet i cili përfshinë gjithë njerëzinë dhe gjithë dheun, ku do të sundojë rregulli dhe

paqa. Komunizmi, një tjetër formë e universalizmit, thotë: Hiq dorë nga vëllau tënd i gjakut dhe unë të bëj vëlla me të gjithë njerëzit e kësaj bote. Kjo bie ere diçka si ajo puna e shejtanit, i cili i paska thënë Krishtit: Bjer në gjunjë, falmu mua dhe unë të fal gjithë pasurinë e kësaj bote. Shkurt, çdo imperializmë, në emrin e një ideje universale, kërkon dhe ka kërkuar: Hiq dorë nga personaliteti tënd dhe nga lirija personale.

Universalizmi ka patur gjithmonë një fuqi të madhe dhe tërheqese në njerëzit e ligshtë. Mirëpo njeriu i forte nuk e pranon. Ay gjen në kraharorin e tij, në familjen e tij, në popullin e tij një bote pa kufi, të cilën ay nuk e shkemben me gjithë universin dhe me gjithë yjte e panumurt të tij.

Nacionalisti i ka vënë vetes kufij nga jashtë, për të ruajtur personalitetin e vet dhe kërkon kufij të gjerë nga brenda, për me qenë i lirë në zhvillimin e natyrshëm të vlerave të tij të prirjeve të tij, shkurt të karakterit të tij. Kurse universalisti thotë: beju si unë, nacionalisti përkundrazi lyp: beju siç je, me fjalë të tjera: qëndro besnik i vetvetes.

E vërtetë që nacionalisti pranon që njeriu ashtu edhe kombi nuk mund të qëndrojnë për vehte dhe të veçuar, se bëjnë pjesë në një tërësi, në të cilën secili është mbështetje dhe mbështetet. Por njerëzia, si një tërësi, është e interesantshme dhe mund të lartësohet vetem atëherë kur individit ose kombi ka dhe di të ruajë karakterin e tij. Nacionalisti i jep një rëndësi të veçantë personalitetit dhe lirisë vetjake. E quan për detyrë të shenjtë të ruajë dhe zhvillojë vlerat e tij; e çmon vehten dhe kërkon që ta çmojnë dhe të tjerët; lyp që t'a ketë fatin e vet vetë në doren e tij; nuk duron të humbasë në turmën e popujvet; nuk duron të bëjë pjesë si një numur i një shoqërie anonime; nuk do të mbshihet prapa një pseudonimi, por del para botës me gjithë personën

e tij përgjegjës, si ay burri i Tepelenës i cili Çdo letër e mbaronte me këto fjalë: "Unë, Aliu, shkruaj". Që t'a presim shkurt në një mënyre konkrete: Ne shqiptaret duam idenë tonë, virtytin tonë, të mirën ose të keqen tonë. Nuk e duam idenë e këtij, atij ose të gjithë botës. Siç thashë, nuk duam të jemi pjestarë në një shoqëri anonime. As duam të jemi dekorativë brenda suazës së një imperatorije.

Por ne një Çast fatzi ligështije dhe të krrupes së madhe na sulmoi armiku befas dhe na mashtroi. Hodhi fare të keqe midis nesh dhe organizoi anarkinë e shemtuar. Ne, që si popull kemi dhënë burra shteti dhe ushtarë të medhenj, jetojme sot turpin, të na heqin nga hunda të huajt! Por krenaria e jonë kombëtare na ndalon të organizohemi nën priz të huaj. Vetëdija e jonë kombëtare dhe instikti vetëmbrojtës na ndalojnë ndër këto kohë fort të rrezikshme të vrasim njëri-tjetrin. Mbi të gjitha, nderi i jonë kombëtar na ndalon të genjejme, të intrigojme dhe të shpifim!

Jemi vëllezër. Duhet të bëhemi shokë!

Mihal Zallari

Shkëputur nga: "Babai im, Mihal Zallari", Elsa Poga, Alb-ass Tiranë-Tetovë, fq. 109

«Atëhere si justifikohen ata njerëz që bëjnë propagandë komuniste në Shqipëri?

Ata nuk justifikohen veçse kështu: janë kalamaj nga trutë, s'dinë ç'bëjnë, ku rrojnë, s'njohin thellë as teorinë marksiste, as gjendjen e botës jo marksiste, janë kalamaj që dehen me ëndrra që s'kanë asnjë posibilitet realizimi».

Propaganda komuniste – 1936

Ismet Toto

Intervistë me Gianluca Iannone Udhëheqësi i CasaPound (Itali)

CasaPound është një parti italiane e së djathtës sociale, formuar në vitin 2003. Në bazë të programit të tyre qëndron e drejta e banimit, kontrolli botor mbi sistemin bankar dhe financiar, mbyllja e tregut për Shtetet që veprojnë në konkurrencë të pandershme, kontrollin e emigracionit dhe garantimin e vendeve të punës.

Në pranverën e vitit 2016 ishin e vetmja forcë italiane (për fat të keq dhe shqiptare) që ju përgjigj apelit të prof. Vladimir Kosturit për të manifestuar në përkrahje të së bijës dhe grave të tjera që kishin rënë pre e dhunës seksuale. E reja shqiptare u rrëmbye dhe u përdhuna, në zonën Prenestinos (Romë) nga një grup romësh.

[...]

Ju keni prezencë të fortë ndër menaxherët e rinj që studiojnë në Universitetin Bocconi. I sheh me librat dhe këngët tuaja...

«Mjafton të mos bëhen si Mario Monti. Ju vjen për mbarë të na identifikojnë me nënproletariatit e Romës, por është vetëm një mënyrë për të na njëjësuar dhe shtypur. Ne të gjithë punojmë, nuk jemi kundër fitimit ekonomik. Nuk duhet t'ju habisin studentët e Bocconit që janë me CasaPound, mes nesh ka njerëz të ndryshëm, edhe profesionistë, kuptohet dhe shumë studentë».

Mes jush do jenë edhe nostalgjikët e përhershëm?

«Nostalgjikë për çfarë? Në kohën e Duçes ne nuk ishim, nuk mund të ndjejmë nostalgji. Jemi fashistë pasi jemi të bindur që kishte të drejtë ai, por ne jemi të rinj, kemi lindur në vitin 2003 me zaptimin e pallatit në rrugën Napoleone III në Romë. Asnjë nostalgji, punojmë për të ardhmen».

Punë e bukur ajo e pallatit, 11 milionë euro që me bekimin e krye bashkiakut të kohës, Veltronit, u hoqën nga pasuria botore: Duçes do t'i pëlqente?

«Po, njëmbëdhjetë milionë: do i jepni ju?

Ishte një pallat i braktisur, i lënë bosh, ishte një ofendim. Ne aty strehuam njëzetepesë familje italiane, e bëmë dhe selinë tonë. Veltroni nuk na e dhuroi, vetëm e njohu si një nga zaptimet historike të Romës, së bashku me dhjetëra ndërtesa të tjera të zaptuara nga "shokët". Kujtohuni që më pas Alemanno harxhoi gjashtë milionë euro për t'i dhuruar kështjellën në Prenestino qendrave sociale».

Shtëpia është baza e programit tuaj politik?

«Është thelbësore. Kemi zgjedhur breshkën si simbol pasi është tetë këndore, pra simbolizon rendin kundër kaosit, por mbi të gjitha pasi mban mbi shpatulla shtëpinë e vet. Çdo gjë duhet të fillojë me kredinë sociale: duhet të jetë Shteti ai që ju jep kredi shtetasve për të blerë shtëpinë, me zero interes. Ç'hyjnë bankat?»

Një studim anglez i ka përshkruar si «një prej lëvizjeve popullsite më të gjalla dhe interesante të Evropës» por edhe «të dyshimta dhe të rrezikuara nga ndikime antisemite dhe të dhunshme». Padyshim që nuk janë as delikate dhe as të prirë për kompromis. Pohojnë me krenari se janë fashistë dhe çdo gjë nis dhe mbaron, ose më mirë rifillon, prej aty. Kjo është arsyeja që të gjithë i mbajnë larg. «Na kërkojnë, por nuk na ftojnë», shpjegon Iannone.

Frymëzoheni nga Ezra Pound, i cili quante fajdetë e keqja e botës: kush janë fajdexhinjtë sot?

«Armiku i parë jemi vetë ne, kur biem në fatalizëm. Fajdexhinjtë më të këqij janë të plogështit, ata që kanë familje dhe të thonë të heqësh dorë, ata që thonë ç'të duhet?»

Kujdes: nuk jeni komplotistë?

«Sigurisht ka grupe pushteti mbishtetërore, një "Vëlla i Madh" që të kontrollon dhe një nënë e madhe që të merr me të mirë, por problemi është që këta mund të veprojnë vetëm nëse populli është i dorëzuar, nuk ka më pika kulturore referimi dhe një vizion për Shtetin».

Nëna e madhe është Evropa?

«Ne jemi evropianist, por Evropa për ne është një atdhe shpirtëror e jo një dinozaur burokratik. Jo rastësisht kemi qenë të parët që kërkuam një referendum kundër euros, pasi është një mjet për të shtypur popujt».

Po fashizmi çfarë është sipas jush?

«Një at i madh, i rreptë, i drejtë dhe ndërgjegjësues».

Të paktën më thoni një gjë ku Musolini ka gabuar?

«Ishte më i mirë nga ç'duhej. Ju dha një mundësi të dytë njerëzve që nuk e meritonin. Për shembull, Badoglio-s, që pastaj e tradhtoi. E dinit që Gjenerali ishte një nga përgjegjësit e katastrofës në Caporetto?».

Është e lehtë të merresh me Badoglio-n: le të bëjmë një kritikë të vërtetë?

«Është pengues ai mentalitet që të shtyn gjithmonë për të gjetur gabimet e fashizmit. Në televizion jam përballur me një tip që fajësonte fashizmin për zhdukjen e një lloji mushkonje pas bonifikimit të kënetave. Dhe e kishte seriozisht. Fashizmi e bëri Italinë moderne dhe kjo është e padiskutueshme. Lufta ishte një gabim? Sot është e lehtë të flasësh por duhen parë rrethanat e kohës».

Pse ju ka atentate ndaj jush, si në Firence ku për Vitin e Ri vunë një bombë në selinë tuaj?

«Sepse ju shtiem frikën, veçanërisht në Toscana, ku jemi duke u rritur. Për këtë atentat u fol shumë vetëm sepse një polic humbi dorën, përndryshe do kalonte në heshtje si të tjerët».

Në Firenze është hera e tretë apo e katërt që ndodh».

Kush ju sulmon?

»Zotërinj që janë të paprekshëm pasi kanë kumbarë në politikë që i mbrojnë. Idiotë të dobishëm që veprojnë në emër të antifashizmit dhe të legjitimuar pasi lëvizin si qendra sociale. Para pak vitesh, një militantit tonë në Romë i shtinë te këmbët, për përgjegjësit nuk u mor vesh gjë».

Kënga juaj kult quhet "Në mëdyshje, bjeri": çfarë bën, nuk reagon?

«Po ajo është ironike. Ne nuk jemi të dhunshëm, ose më mirë, ne jemi gandistë. Edhe pse na akuzojnë për dhunë e racizëm viktimat jemi gjithmonë ne, si Gandhi, justifikojmë dhunën si reagim: nëse na sulmojmë, nuk marrim arratinë, ajo do të ishte poshtërsi».

Këto atentate ju bëjnë reklamë...

«Urdhri është të flitet sa më pak, të mos na krijojnë shikueshmëri. Gjatë fushatës për referendumin ministri Boschi akuzoi partizanët se votonin si ne, na krahasuan me të keqen absolute, paçka se na përmendi kumbara e reformës askush nuk më ftoi në televizion për të shfaqur arsyet tona: të paktën për mirësjellje duhet të më kishin pyetur dhe të më jepnin mundësinë të mbrohesh».

Do të shkonit me dëshirë në televizion?

Patjetër, merrem me politikë, gjëra për të thënë kam».

Më shpjegoni diçka, ç'nevojë ka Italia për një tjetër formacion të djathtë?

«Ne ekzistojmë pasi e djathta institucionale ka dështuar. U treguan të aftë të mbushnin sheshet për vite me radhë edhe duke e paguar me burg, por kur arritën në pushtet u shkërmoqën».

Unë do të thosha u berluskonizuan...

«Në rastin më të mirë. E vërteta është që ajo klasë drejtuese nuk kishte materialin njerëzor dhe kulturorë për të qëndruar e fortë».

E keni fjalën për Finin?

«Fini mban peshën e tradhtisë, por nuk ishte i vetmi, mëkëmbësit i pranuan zgjedhjet e tij».

Por Meloni u përpoq ta riniste, themeloi Fratelli d'Italia...

«Meloni ka votuar 42 herë qeverinë Monti. Nuk luftoi për të mbrojtur ushtarët, aty ishte kur i dërguan në Indi. Giorgia është një nostalgjike e Fiuggit, por origjina e Movimento Sociale-s [Lëvizja Sociale], ka humbur ambicien ideologjike. Në të vërtetë tani të gjithë e kanë mendjen te pasuria e Fondacionit të AN [Alleanza Nazionale], një thesar i lënë në trashëgim nga të mbijetuarit dhe nga militantët e vjetër; po ndajnë plaçkën, Fini me shtëpinë në Montekarlo është një shembull grabitjes që po bëhet».

Do e dërgonit përsëri Borghezio-n në Evropë, apo jeni penduar?

»Pyetje e bukur, ke ndonjë tjetër? Borghezio gjithmonë është treguar idealisht i afërt me lëvizjen tonë dhe na kërkoi ndihmë, ne pranuan dhe ishim vendimtarë në zgjedhjen e tij. Nuk jam penduar, ishte një goxha sprovë, vetëm ne mund bënim që një legjist të zgjidhej në Romë».

Tani me Legën çdo gjë është e mbyllur?

«Salvini është i zoti në marrëdhëniet me publikun, por brenda vitit kaloi nga zjarrvënës në zjarrfikës. Nga një anë do të revolucionarizojë Evropën e pastaj hipën në tribunën e Bolonjës me Berluskonin për të kërcyer valle popullore. Mu shmang njëherë që e takova rastësisht në Milano».

Në fund të fundit është i ndruajtur: nuk mendoni se në të ardhme rrugët tuaja mund të bashkohen përsëri, politika e tillë është?

«Është një oportunist. Herën e parë e ha, por e dyta do ishte për fajin tim. Meloni dhe Salvini janë në funksion të sistemit, njëri bën si i çmendur, del kundër euros, e tjetra flet për të djathtën sociale pastaj të dy i ftojnë për spektaklet e tyre në

televizion. Unë merrem me politikë 365 ditë në vit, është komplet tjetër gjë».

Çfarë është për ju të merresh me politikë?

«Për shembull të vetëfinancohesh. Shumë nga selitë tona janë pub-e që financohen me tregti, me shitjen e bluzave dhe disqeve muzikore. Jemi të vetmit që në politikë japim e nuk marrim».

Keni edhe shkolla futbollit...

«Po, në Leçe, dhe një skuadër të kategorisë së parë në Romë. Por me futbollin duhet pasur kujdes, se ndryshe fillojmë e rrihemi njëri-tjetrin. Është përçarës dhe tashmë tifozëritë nuk kanë më lidhje me politikën. Ju them se ka shumë ish futbollistë që na vlerësojnë, njerëz që në Romë kanë fituar kampionatin e Serisë A».

Çfarë mendoni për Di Canio-n, që pas dyzetë vitesh që ecën në korsinë e djathtë e pastaj fut indietron.

«Është e trishtueshme kur dikush arrin në pikën që mohon dhe tatuazhet e veta. Ja dhanë përgjigjen tifozët e Lacios».

Po Duçja me ç'ekip ishte tifoz?

«Ky është një mister. Ata të Interit thonë që ishte internist, por ai i detyroi të ndërrojnë dhe emër. Të tjerë thonë që ishte me Lacion, për shkak të shqiponjës, pastaj ka nga ata që thonë i dha kampionatin Romës në '42...».

Pak a shumë si Berlusconi, që në fillim ishte në mëdyshje mes Interit dhe Milanit...

«Berlusconi është një ekspert i madh i marketingut, loz me dy porta. Të gjitha pohimet e tij pro Musolinit duhen parë në këtë këndvështrim».

Por ai ishte i pari që i hapi dyert të djathtës...

«Sot e kësaj dite një kalendar i Duçës shitet më shumë se ai i me yjet e Hollywood-it lakuriq. Berlusconi këtë e di dhe kur i nevojitet i shkel syrin dhe Musolinit».

Po juve ju pëlqen Berlusconi?

«E kemi votuar pak, e kemi mbështetur shumë, kur u fut në politikë dhe ju hoqi

komunistëve tortën nga duart pikërisht kur ata mendonin se do të qeverisnin me makinën e hareshme të luftës. Berlusconi na ka dhënë shumë kënaqësi, por kishte shumë pushtet dhe nuk e shfrytëzoi».

Tani për t'u rikthyer pret vendimin e Strasburgut...

«Berlusconi në vitin 2011 u bë viktimë e një grushti Shteti, ka të drejtë Tremonti, që erdhi dhe na e shpjegoi në CasaPund. Dhe heqja nga Kuvendi në bazë të një ligji me fuqi prapavepruese ishte një padrejtësi. Shpresoj që si njeri të rehabilitohet, si politikan as nuk më intereson. Do të duhej të tërhiqej. Po si, të bëjnë grusht Shteti dhe ti i mbështet? Ka një gjë që s'shkon, do të thotë që ose të bëjnë shantazh ose të volit...».

S'të pëlqyeka njeri...

«E di, në fund duket sikur problemin e kam unë...».

Jo për gjë, por është e vështirë të bësh gjë pa u futur në aleanca...

«Unë besoj se nuk është bashkimi që bën fuqinë por fuqia që bën bashkimin. Faktet thonë që kemi të drejtë, po rritemi, nuk flas për ëndrra në sirtar. Për momentin jemi pakicë, por fituese.

Rri buzë lumit dhe pres».

Çfarë, katastrofën?

«Në fakt, duke qenë një lëvizje popullore jemi të fortë aty ku ka pakënaqësi sociale».

Ato vota sot i shkojnë Lëvizjes Cinquestelle...

«Nga nëntë milionë vota që mori në 2013, të paktën një milion e gjysmë janë potencialisht tonat. Të tjerat, shumë të tjerat, janë mes pesëdhjetë për qind të italianëve që nuk shkojnë të votojnë».

Por Cinquestelle nga pikëpamja e numrave është një gjigand krahasuar me ju: pse italianët i votojnë?

«Për apatizëm, sepse shtypi thotë që ata janë zëri i protestës së tyre dhe njerëzit ende i besojnë».

Çfarë nuk ju bind te ajo parti?

«Janë si një mur gome, shumë të dobishëm për sistemin. Quhet teknika e përplasjes: vjelin problematikat sociale, bëjnë sikur i përfaqësojnë dhe i gërryejnë nga brenda. Thoshin se do hapnin Kuvendin si kuti konserve, janë ende aty të nginjur dhe votojnë kundër krimit të klandestinitetit dhe pro martesave gay».

Pikërisht dje Grillo deklaroi ndarjen nga euroskeptikët e Farage dhe bashkimin në aleancë me Alde-n e përkrahësve të Merkelit.

«Pesëyjet janë bluffi më i madh në historinë italiane. Premtojnë diçka e pastaj bëjnë plotësisht të kundërtën».

Ju jeni të vendosur kundër refugjatëve?

«Nuk është çështje racizmi por ekonomike. Ne jemi për mbrojtjen e italianëve. Refugjatët janë në funksion të pasurimit të shumëkombësheve dhe të atyre që janë të pasur, kjo pasi pranojnë paga që italianët nuk do t'i pranonin. Kujdes, thashë paga, jo punë. Ka një projekt, dhe është në ecuri, për zëvendësimin e krahut të punës me kosto të ulët, sjellin nga Azia, Afria dhe Amerika e Jugut, njerëz që janë të gatshëm të punojnë për dy lekë. Pastaj është dhe e majta, që i shqyen dyert sepse do votat e tyre, kjo duke parë edhe që italianët nuk votojnë më. Por sistemi bie në qark të shkurtër pasi refugjatët nuk janë si pret e majta që të jenë. Nuk janë të zbutshëm».

Italia është e djathtë?

«Padyshim që është antikomuniste. Është në kujtesën historike të italianëve fakti që janë mirëqeverisur nga e djathta. Ndoshta kjo është arsyeja pse Napolitano, së fundmi, ka vënë në dyshim vlerën e votimit universal: ka njerëz që mërzhiten kur nuk votojnë si na thonë. Dëgjova një gazetare të Rai3 që pas zgjedhjes së Trump-it ankohej në televizion se: "Nëse njerëzit nuk e kanë kuptuar si votohet, ne gazetarët për ç'a duhemi?". Problemi është që e kishte

seriozisht.

Është diktator?

«Jo më shumë se Hillary».

Pra, ju në Siri mbështesni Asadin?

«Patjetër, kemi shkuar edhe atje për ta ndihmuar. Siria është një Shtet sovran dhe Asadin e do populli i tij, është një kështjellë kundër Isis-it, që u krijua për shkak të Shteteve të Bashkuara që donin të eksportnin demokracinë në botë dhe bënë vetëm dëme. Ne në Itali, para tetë vitesh bëmë marrëveshje ekonomike me Gedafin dhe Mubarakun dhe emigrimi ishte i kontrolluar. Kjo nuk i shkante për shtat dikujt dhe shiko ku gjendemi sot».

Uroni që Le Pen të fitojë zgjedhjet?

«Është më mirë se të tjerët, por pak gjëra do të ndryshojnë. E shoh të drejtuar te politikisht korrektja. E shoh si një lloj Alleanza Nazionale-n, pesëmbëdhjetë vite më vonë».

Ç' mendoni për Bergoglio-n?

«Bën punën e tij, por nuk kuptoj pse udhëheqësi i një vendi duhet të kërkojë më shumë refugjatë për kombet e tjera. Kundrejt Italisë ai është një element i huaj dhe si i tillë duhet të sillet. Le të mendojë për të përtejmen, për të këtejmen mendojmë vetë».

Ju akuzojnë si anti të krishterë...

«Nëse jemi, jemi të parakrishterë. Ne jemi të bindur që feja i përkon sferës vetjake të njeriut. Nuk tolerojmë ndërhyrje, jemi për një Shtet laik».

Musolini kishte marrëdhënie të mira me islamin...

«Duke qenë udhëheqësi i një Shteti at bisedonte me të gjithë, sidomos me ata që shtrihen në brigjet e Mare Nostrum-it, edhe pse tani nuk na e lënë ta quajmë më ashtu. Për ne problemi nuk është islami në vetvete, por islami këtu në Itali. Nuk i përket kulturës tonë. Asadi është mysliman, por në shtëpi të vet, e mbështesim».

Intervistoi Pietro Senaldi, "Libero", 9.I.2017, f. 8-9.

Përkthimi Red. Nutrika.

Nuk ka trupë ushtarake në botë që, për shkak të nevojave të propagandës dhe të fundosjes të së vërtetës, me metodologjinë e "koqes mangët", të jetë bërë subjekt pohimesh kundërthënëse në gjendje të krijojnë një mjegull të përhershme, sa Divizioni SS Skanderbeg.

Për sllavët, në një krah qëndron nevoja e alibisë për fajësimin kolektiv të shqiptarëve dhe në tjetrin fshikullimi për ndjesinë e mos të qenit të klasifikueshëm për trupat elitë të kontinentit, kuptuar jo vetëm si hapësirë gjeografike, të cilit përpiqen t'i përkasin ("faj" dhe "elitë" cilësuar sipas palëve), fshikullim që rritet në ditët tona për shkak të deformimeve që vetëm mendja sllave mund të prodhojë (duke pasur parasysh këtu grupime të vetëquajtura të nacionaliste dhe njëkohësisht nostalgjike, madje trashëgimtare, të së shkuarës bolshevike). Kështu, paçka suksesit të Operacionit "Kokëkricuri", ndihmës humanitare për civilët, përfshirë edhe atyre sllavë dhe dekorimit të oficerëve drejtues, shqiptarët "shfaqen" të gjithë "nazistë" dhe njëkohësisht Divizioni nuk arriti organikën e plotë, Divizioni shfaqet njëkohësisht i aftë për operacione në shkallë të gjerë por dhe pa kurrfarë peshe, ushtarët njëkohësisht trima dhe frikacakë, të rrezikshëm dhe njëkohësisht pa vlerë ushtarake... dhe kështu me radhë.

Sa i përket historiografisë zyrtare shqiptare, sot si dje, gjithmonë në mëdyshje mes vënies në dukje të "reaksionit" (dje përdorur si figurë letrare, sot si justifikim) dhe kujdesit për të mos kaluar cakun përtej të cilit historia nuk mund të bolshevizohej, vendosi në pjesën më të madhe të heshtte duke i hapur kështu plotësisht rrugën qëndrimeve të sponsorizuara.

Në përpjekje për të holluar mjegullën e përmasave të atentatit ndaj të vërtetës kemi vendosur të botojmë mendimet e njerëzve të Divizionit, mendime që, në një luftë, në luftën me përmasën më të plotë

ideologjike që është zhvilluar në këtë anë të botës përbëjnë dhe arsyet që futën, krahë më krah, në një llogore shqiptarë e gjermanë, në Siujdhesën Ilire, apo gjermanë e francezë, italianë, skandinavë e baltikë gjetkë.

E vërteta!

prej SS-Kolonelit Schmidhuber
Komandant i Divizionit Malsuer SS
"Skanderbeg"

E vërteta asht ushqimi shpirtnuer i një populli. Sikur trupi i njeriut nuk mundet të rrojë pa ushqim, ashtu edhe populli nuk mundet të rrojë pa mësue të vërtetën. Ay, qi e rrenë popullin asht si nji, qe i jep popullit helm, qi e mbytë dalë-kadalë deri sa t'a shuej fare. Ksisoj helmi asht edhe rrene, që Divizioni SS "Skanderbeg" do të çohet në kasaphane për Gjermanin. Gjermanët nuk janë si Englezit, prandaj për frontet e veta dhe për vendin e vet luftojnë vetë ata në këtë luftë Evropjane dhe nuk kanë nevojë për popuj të tjerë. E vërteta asht, që Divizioni "Skanderbeg" asht caktue vetëm për me ruejtë atdhën e vet, që të mos shkelet edhe nji herë prej anmikut e sidomos prej Komunizmit, shkatërrues i popullit. Shqipnija pamvarsin e vet dhe sidomos Kosova lirin e vet e ka pasë fitue në sajë t'Ushtris Gjermane t'Adolf Hitlerit. Këjo asht nji e vërtetë qi asnji shqiptar nuk mundet t'a përgënjeshtrojë. Sa për ruejtjen e kësaj liriye, si nuk ka pasë Shqipnija qysh prej kohve të Skënderbegut, qysh prej pesqind vjetësh, këjo asht nji punë që i përket popullit Shqiptar. Me gjith që në Evropë pak dihet mbi Shqipnin, por nji gja dihet dhe asht ba fjalë popullore: Trimnija, Burrnija dhe Besa e Shqiptarit. Dhe Adolf Hitleri e quejti të denjë nji popull të këtillë me këto virtyte, për me i krijue nji divizion populluer të vetin me instruktora gjerman dhe me e pajisë me armët moderne gjermane. E organizueme

ushtarakisht në këtë mënyrë, fuqija luftarake e ushtarake shtohet aq, sa bëhet e pathyeshme. Coptimi i fuqisë, drejtimet e qëllimet e ndryshme, interesat vehtjake, këto e prishin një popull, i cili asht në vetvehte i shëndosh, i pastër dhe i ndershëm.

Divizioni "Skanderbeg" në shumicë ka me qenë i përbamë prej katundarve. Dhe bash ndër këta ka me gjetë burimin e forcës së vet. Katundarija ka me i dhanë Divizionit "Skanderbeg" oficerat dhe nënoficerat. Në këtë mënyrë Divizioni ka me përmbushë edhe një detyrë të çmueshme politike popullore. Ushtria asht kjenë gjithmonë shkolla e popujve. Ushtria ka kjenë gjithmonë pasqyra e popullit dhe populli vetë pasqyra e Ushtrisë.

Duhet të marri fund një herë e mirë mentaliteti për me e quejtë katundarin klasën ma t'ulët. Intelektuali, që nuk çmon katundarin, siç duhet, tregon se inteligjencën e ka sa për sipërfaqe, kurse kryet e ka bosh. Intelektualismi pa katundari asht i dënuem për vdekje. Intelligjenca nuk e banë bukën vetë. Intelektualismi i qyteteve kish me u shfarue, po mos të merrte gjak prej katundaris. Kur trupi i nëpunësve dhe i oficerave të një populli përbahet vetëm nga klasa intelektuale, atherë ata kurr nuk mund të bahen prisat e popullit. Nëpunsat e oficerat janë shërbëtorët e parë të popullit. Nuk asht krijue populli për nëpunësat e oficerat, por përkundrazi nëpunësat e oficerat janë vue në punë për popullin. Kur oficerat si prijssa në krye t'ushtarve të vet ruejnë kufinin e rrezikuem nga anmiku, asht detyra e nëpunsave të ndershëm me ushtrinë mbrenda në Shtet një administratë të pastër dhe të drejtë, tue i a ndamë popullit baras dhe pa dallim pasaniku e varfanjaku detyrat e barrën e përbashkët. Një nëpunës, që merr ryshvet, asht kriminel ndaj popullit. Dhe aji që e pranon ryshvetin, nuk asht ma i mirë se aji qi i ndihmon një hajduti.

Nuk asht e pranueshme, që nëpunësat e emnuem prej Qeveris, t'i a ngarkojnë Qeveris fajin e pazotzsis së tyne. Në këtë mënyrë bajnë një krim, tue e vue në dritë të keqe qeverin e popullin. Nëpunësat nuk kanë marrë urdhën prej Qeveris për me hangër ryshvete, as me tregue pazotzsin e tyne. Qeverija pret prej tyne, që ata t'i shërbejnë me zell të palodhshëm popullit. Kur nëpunësat e kryejnë këtë detyrë, atëherë ka drejtësi dhe populli asht i kënaqun.

Këto janë të vërteta, dhe zbatimi i tyne siguron qetsin e rregullin mbrenda në një shtet. Atje ku këto të vërteta nuk zbatohet, atje nëpunsat e çelin rrugën komunizmit.

Vetëm prej një brumi të pastër mundet me dalë një ushtri e pastër! Ajo duhet të dijë, përse lufton.

Prandaj edhe Divizioni SS. "Skanderbeg", tue hye në shpirtin e Skanderbegut ka me përfaqësue ndërgjegjen e popullit dhe nuk ka me hezitue, kur të shfaqet nevoja me vleftësue këto të vërteta.

«Lidhja e Dytë e Prizrenit», V 1, N. 12, dt 4.VI.1944, f. 1



Stema e Divizionit SS Malor Skanderbeg


Sport: Regbi

Sot në Shqipëri ka disa djem që kanë zgjedhur të ndërtojnë dhe të zbavitën njëkohësisht. Sporti i regbisë nuk është një sport shumë i njohur tek shqiptarët, por është një nga ata lloj sportesh që një shqiptari do ti shkonte më shumë. Nuk mund të lëmë këtu pa përmendur pjesëmarrjen e shqiptarit Ornel Gega në përfaqësuesen italiane të regbisë. Njëa nga 10 më të mirat në botë.

Forcë fizike, rezistencë, agresivitet por mbi të gjitha disiplinë. Kush nuk i ka këto cilësi mund të luajë atë sportin tjetër ku bëhet gol. Çfarë është regbia!? Është një sport mbi të gjitha ekipi, nuk ka një yll në ekip, munda dhe djersa paguhen, luftëtarë në fushë dhe shokë jashtë, dhe në fund të çdo ndeshjeje, të gjithë për birra.

Falë mundit të disa djemve dhe dëshirës së shumë të tjerëve sot në Tiranë ka dy ekipe regbie, Klubi Regbisë Tirana dhe Klubi Regbisë Ilirët. Ekipi i Tiranës numëron sot dhjetra ndeshje ndërkombëtare dhe merr pjesë në kupën Skënderbeu bashkë me dy ekipe nga Kosova.

Ke dëshirë të dish më tepër?! Pa ndroje dhe me dëshirë, çunat mund ti gjesh tek fushat e ish-kompleksit "Dinamo" çdo të shtunë dhe të djelë, ah...edhe kur është -3 gradë C.



Libër: Kujtimet e Johakim Von Ribentrop

Johakim Von Ribentrop, Asmbasador dhe Ministër i jashtëm i Rajhut të III-të. U akuzua padrejtësisht si "nxitës i luftës", përkundrazi përpoq për të ruajtur paqen deri në fund të jetës së tij. Faqet që ju propozojmë janë një dëshmi në vetën e parë e një prej personazheve më të rëndësishëm i cili mbrojti qëndrimet dhe zgjedhjet e tij edhe kur u gjend i akuzuar. Asnjëherë nuk mendoi të tradhtonte vendin e tij. I bindur se armiqte e vërtetë nuk ishin në perëndim por thellë në lindje. I dëshiruar për një paqe dhe mirëkuptim me kushërinjt ishullorë, ai dhe Rajhu u gjendën të rrethuar në perëndim dhe në lindje nga një lloj force e padukshme për njerëzit normalë e cila kishte plane për ta rrëzuar në themel Europën. Kjo lloj force e padukshme për syrin e një gjermani, italiani, anglezi apo amerikanë kishte krijuar në një nga laboratorët e saj në virus të kuq i cili po lëshohej nga stepat e lindjes për të infektuar europianët. Të gjitha përpjekjet e Ribentropit e shokë u shkatërruan, çdo përpjekje u quajt "nxitje", çdo parandalim lufte u quajt "agresion". Sot nuk është më nevoja të numërojmë të vdekurit nga virusi i kuq ashtu si nuk është nevoja të tregojmë aktet e tragjedisë europiane e cila po vazhdon të luhet.

Prandaj. A kishte Ribentropi dhe shokë të drejtë? Sigurisht!



Më mirë i Vdekur Se i Kuq - M V S K

Më në fund një parti e majtë, nga ato të së majtës së vërtetë, nga ato që shqetësohen për të varfrit, për të pastrehët, një parti e krijuar për t'i dhënë "fund njëherë e mirë kësaj situatë absurde, ku 5% jetojnë në saraje, e 95% jetojnë për mbijetesë, e disa flenë me kartona në borë, me shpresën se do të mbijetojnë edhe një natë."

Për besë po!

Nëse nuk besoni, mund të shkoni vetë të ndiqni mbledhjet e tyre në Hotel PLAZA, dhe do të bindeni... që e majta radikal shik nuk zhgënjën asnjëherë.

Gazeta britanike "The Guardian" njofton se çdo ditë me qindra gra venezueliane kalojnë kufirin me Kolumbinë për të shitur flokët e tyre. Me ato pak të holla që përfitojnë përpiqen të sigurojnë bukën e gojës dhe barnat e nevojshme për vete dhe familjet e tyre.

Venezuela, për shkak të politikave komuniste, prej vitesh po kalon një krizë që çdo ditë e më shumë po merr trajtën e zisë së bukës.

Një lajm për duhet ndjekur nga 55% e shqiptarëve, pasi rezultati i politikave ekonomike të kuqe, kudo dhe kurdoherë, është i njëjti: uria!

<https://www.theguardian.com/world/2016/dec/05/venezuela-women-hair-selling-colombia-basic-necessities>

Si funksionon sistemi arsimor në Shqipëri? Sipas Akademisë së Shkencave, gjatë çlirimit të Tiranës mbetën të vrarë mbi 2 000 ushtarë dhe oficerë (madhorë) gjermanë dhe 417 të vrarë dhe të plagosur mes partizanëve (Historia e Popullit Shqiptar IV, Toena, Tiranë 2008, f. 102).

Është mirë të kujtojmë se gjatë çlirimit të Parisit u vranë 3 200 ushtarë gjermanë dhe 1 600 francezë.

Mirë, mund të thuhet se funksionon mirë.

Në pasditen e 16 janarit 1969, studenti çek Jan Palach, në formë proteste ndaj pushtimit bolshevik, duke u spërkatur me benzinë i vuri zjarrin vetes.

Në varrimin e tij morën pjesë mbi 600 000 njerëz të lirë.

Sot, si atëherë, cilësohet simbol i qëndresës antikomuniste dhe sakrifikimit për liri... për të tjerët se bluzat e çakmakët e studentëve shqiptarë janë të zëna nga Guevara.

"Ah, vjershëtor! (britnë njëqind zëra, pse s'na the më parë vjersha aq të mira? Pse na mendojë me gjëra që s'na pëlqejnë? Eja, kthehu, mos ik, të gjitha janë të falura e të ndjera: Vetëm të na bësh dhe të tjera vjersha të mbaruara si këtë që dëgjuam, dhe do të të nderojmë mase. Ku ta dijim ne se qenkeshe një vjershëtor aq i madh? Faj s'të kemi, ke faj ti që na shfaqe vetëm ligësinë tënde, dhe mbajte të fshehura madhësitë që të falnë Boriga e Dushku. Eja, se tani të kuptojmë e të duam!"

Thërriti njëzëri tabori i intelektualëve, pasi Doli vuri qelshen.

Shumica e të arrestuarve gjatë protestave të dhunshme në Portland të Shteteve të Bashkuara, as nuk kishin shkuar për të votuar.

E majta, si kudo.

<http://www.kgw.com/mb/news/local/more-than-half-of-arrested-anti-trump-protesters-didnt-vote/351964445>

Refuzojmë refugjatë në Shqipëri



Sipas të dhënave nga shtypi, për shkak të temperaturave të ulëta, në Republikën e Shqipërisë kanë humbur jetën 12 njerëz.

Sa prej tyre ishin muxhahedinë?

E thjeshtë, asnjë!

Ndërkohë që Qeveria në Tiranë tregohet e aftë të sigurojë banim të përhershëm, ngrohje dhe ushqim për disa mijëra terroristë të huaj, shtetasit shqiptarë vdesin rrugëve nga i ftohti.

Integrimi i "refugjatëve" vazhdon me ritme të kënaqshme ...


Selanik, refugjatët përdhunojnë studenten në ambientet e universitetit

<http://top-channel.tv/lajme/artikull.php?id=336987>

Hungaria i thotë JO! dërgimit të detyruar të emigrantëve në territorin e shtetit të saj! Shembull që duam dhe në Republikën e Shqipërisë! Kërkojmë referendum për muxhahidinët (Ushtarët e Allahut) që na i kanë sjellë në Republikën e Shqipërisë!

Emigrantët afro-aziatikë pushtojnë sheshin kryesor të Bautzenit në Gjermani, që shkakton reagimin e banorëve të cilët organizohen e pas një orë beteje me mjete rrethore, arrijnë t'i shporrin afro-aziatikët nga qyteti:

<http://www.bbc.com/news/world-europe-37372029>



Ndërsa shqiptarët vrasin veten nga varfëria e flejnë rrugëve, pushtuesit e huaj që kanë zbarkuar në Shqipëri marrin laptopë e mjete të tjera të paguara nga taksat tona, që t'u sigurohet një ambient sa më i mirë punë në përhapjen e pushtetit të Allahut në Shqipëri. Jepni kushtimin të çlirojmë Shqipërinë nga hordhitë e huaja pushtuese!

Vendet që kanë ngritur mure për emigrantët

<http://top-channel.tv/lajme/artikull.php?id=336050>

Nutrika, në respekt të ligjeve në fuqi të Republikës Shqiptare dhe të traditave të mira të popullit shqiptar, ndihet përgjegjëse vetëm për shkrimet publikuar në emër të Redaksisë. Shkrimet e palëve të dyta pasqyrojnë mendimet e autorëve përkatës dhe jo domosdoshmërisht të Redaksisë. Përdorimi i materialeve mbrojtur nga e drejta e autorit ka vetëm qëllime didaktike dhe jo ekonomike.

Për sa më lartë, Nutrika nuk ndihet përgjegjëse për thartime apo lëndime mëndjendriturish.



Printimi i kësaj fletoreje është bërë me kontribut vullnetar. Nuk ka një çmim por ka një kosto. Shpërndahet falas.